



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>414</u>	Nr. /faq/ Br. str / No. pg <u>45</u>	
Data / Datum / Date: <u>24.02.2020</u> Pejë / Pod		

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Adresa; Rruga e UÇK-së, se, 30000 Peje Republika e Kosovës, Nr. tel + 383 39 432 270, info@unhz.eu

RREGULLORE PËR PËRSHKRIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN E UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Pejë, Shkurt 2020

Në mbështetje të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Nr. 04 – V – 662, të datës 30 Maj 2013, neni 23, paragrafi 1.3, Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr.03/L-149, Rregullore Nr.09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASH, Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Universitetin "Haxhi Zeka" – Pejë nr 247/2020, Rregulloren Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë, Këshilli Drejtues i Universitetit Haxhi Zeka në Pejë, me datë 21.02.2020, miraton këtë:

RREGULLORE PËR PËRSHKRIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN E UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË

PJESA I :

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ("UHZ"), duke përfshirë funksionet dhe përgjegjësitë e zyrave dhe njësive organizative sipas përshkrimeve të përgjithshme të punës.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, Administratën Qendrore dhe administratën e Njësive Akademike.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë dhe organeve tjera të administratës shtetërore nën mbikëqyrjen e saj përcaktohen me Shtojcën 18 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe legjislacionit përkatës në fuqi.

Kapitulli I

Sipas kësaj Rregulloreje, organizimi i punës mundëson aplikimin e legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe akteve të brendshme të Universitetit, si dhe aktiviteteve të tjera që janë në kompetencë të Universitetit.

Neni 3 Struktura Organizative e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë

1. **Struktura e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë është si vijon:**
 - I. Zyra e Rektorit
 - II. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
 - III. Zyrat në Administratën Qendrore
 - IV. Zyra Administrative në Njësitë Akademike
2. **Numri i të punësuarve në administratën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë parashihehet të jetë (152).**

Neni 4

Zyra e Rektorit

1. Zyra e Rektorit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, përbëhet nga:
 - 1.1 Rektori;
 - 1.2 Prorektorët;
 - 1.3 Këshilltar i Rektorit
 - 1.4 Asistent ekzekutiv
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Rektorit dhe prorektorëve përcaktohen me Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 5

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë përbëhet nga:
 - 1.1 Sekretari i Përgjithshëm;
 - 1.2 Zyrtar Ekzekutiv;
 - 1.3 Asistent Ekzekutiv;
 - 1.4 Zyrari për Certifikim
2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Sekretarit të përgjithshëm të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, janë të përcaktuara me Statutin e Universitetit.

Neni 6

Zyrat në Administratën Qendrore

Në kuadër të Administratës Qendrore funksionojnë këto zyre:

- Zyra e Auditimit të Brendshëm
- Zyra e Administratës dhe Shërbimet e Përgjithshme
- Zyra për Marrëdhënie me Publikun
- Zyra për Çështje Akademike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie
- Zyra për Kërkime Shkencore
- Zyra për Çështje Studentore
- Biblioteka Qendrore Universitare
- Zyra për Bugjet dhe Financa
- Zyra e Prokurimit
- Zyra e Teknologjisë së Informacionit
- Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim
- Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Zyra për Zhvillim të Karrierës
- Zyra për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore
- Zyra Ligjore
- Zyra e Protokollit dhe Arkivit
- Zyra për Shërbime të Përgjithshme dhe Transportit

Neni 7

Në kategoritë funksionale përfshihen këto nivele:

- Nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues (DL)
- Nëpunës civil i nivelit drejtues (D)
- Nëpunës civil i nivelit profesional (P)
- Nëpunës civil i nivelit tekniko – administrativ (A)

II. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Është zyrtari më i lartë i administratës;
- Është udhëheqës i Administratës Qendrore;
- Është mbikqyrës i drejtorëve të departamenteve, njësive dhe Sekretarëve të Fakulteteve;
- Është zyrtar përgjegjës për udhëheqje efikase, ekonomike dhe efektive të Universitetit;
- Është zyrtar përgjegjës për përgatitjen teknike të procesit buxhetor;

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Rektori i UHZ-së.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Kualifikimi dhe aftësitë për sekretarin e përgjithshëm janë të parapara me Statutin e UHZ-së: Duhet të jetë nga fusha profesionale e drejtësisë, kualifikime dhe përvojë e duhur, aftësi të dëshmuara organizative dhe menaxhuese, njohuri të mjaftueshme për proceset e arsimit, artit dhe kërkimeve, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze dhe njohja e punës me kompjuter.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Pesë vjet përvojë pune të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: DL

1.1 Zyrtar Ekzekutiv

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Harton rregullore, udhëzime dhe rekomandime për organet e Universitetit;
- Jep sqarime për dispozita ligjore, për Statut dhe për akte të tjera normative të zbatueshme në Republikën e Kosovë;
- I përgatit format e vendimeve dhe të kontratave të cilat lidhen me personelin e Universitetit dhe me subjektet e tjera me të cilat Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, ka raporte kontraktuese;
- Përgatit edhe padi ndaj personave dhe subjekteve të tjera të cilat i shkaktojnë dëme Universitetit;
- E përfaqëson Universitetin në të gjitha procedurat të cilat zhvillohen në gjykatat e Kosovës dhe në organet e administratës, sipas autorizimit të sekretarit të përgjithshëm dhe rektorit;
- Nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm jep përgjigje në kërkesat që i drejtohen Këshillit Drejtues dhe Senatit, si dhe jep sqarime juridike për organet e Universitetit;
- I përgatit materialet për mbledhjet e organeve të Universitetit dhe merr pjesë në mbledhje, shkruan procesverbalin, vendimet, konkluzionet, rekomandimet si dhe ekstraktin e procesverbalit nga mbledhjet e organeve të Universitetit;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Juridik katër vjeçar ose master në Fakultetin Juridik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

1.2 Asistent ekzekutiv

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Koordinon punën në zyrën e sekretarit të përgjithshëm në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për takimet, udhëtimet zyrtare etj;
- Regjistron takimet, thirrjet telefonike, nga vendi dhe jashtë vendit, mban adresarin e numrave të telefonit;
- Kujdeset që telefonatat në zyrën e sekretarit përdorën vetëm për nevoja zyrtare;
- I mirëpret vizitorët dhe bashkëbiseduesit në telefon, përcjell mesazhet nga sekretari dhe i pranon ato për sekretarin;
- Merr pjesë në takimet e sekretarit me delegacione të huaja për përkthime nga shqipja në anglisht dhe anasjelltas;
- Merr pjesë në përgatitjen e mbledhjeve, konferencave, duke përfshirë këtu edhe prenotimet hoteliere;
- Informon sekretarët e fakulteteve, udhëheqësit e zyrave të administratës së UHZ-së dhe personelin tjetër administrative për takimet që organizohen nga sekretari dhe për takime tjera që organizohen nga Universitetit;
- Informon anëtarët e komisioneve për mbledhjet që organizohen në nivel të universitetit;
- Përkujdeset dhe përgjigjet për ruajtjen e sekretit zyrtar në çështjet e universitetit;
- Përpunon në kompjuterin personal ose shtyp letrat, raportet, memorandumet, telefakset e të gjitha dokumentet dhe formularët e tjerë të Universitetit që ndërlidhën me çështjet operuese të Universitetit;
- Organizon dhe bënë arkivimin e dokumenteve në kopje elektronike dhe kopje të fortë, të të gjitha dokumenteve të lëshuara nga sekretari, duke i respektuar rregullat e përgjithshme të arkivimit,
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Dy vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

1.3 Zyrtar për certifikim

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Është përgjegjës që të sigurojë se kushtet e zbatueshme të një kontrate publike janë të përmbushura para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës;
- Është përgjegjës që të sigurojë se shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike bëhet në pajtim me Rregullat e KMF-së (Rregullat për Kontrollin dhe Menaxhimin Financiar);
- Është përgjegjës për rishikimin e dokumentacionit lidhur me shpenzimin e buxhetit;
- I identifikon dhe menjëherë raporton me shkrim tek udhëheqësit për të gjitha rastet e mosrespektimit të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike, ndërsa për rastet e mosrespektimit të Ligjit mbi Prokurimin Publik raporton tek Auditori i Përgjithshëm;
- Mban shënime gjithëpërfshirëse me shkrim për të gjitha rastet e mosrespektimit të ligjit për së paku shtatë (7) vjet.
- I ushtron të gjitha detyrat të cilat i janë caktuar sipas Rregullave KMF.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, i certifikuar nga MEF - Departamenti i Thesarit, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P**1.4 Asistent Ekzekutiv i Këshillit Drejtues****I. Detyrat – përgjegjësitë:**

- I përgatit materialet për takimet e Këshillit Drejtues;
- E mban procesverbalin dhe e shkruan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhjet e Këshillit Drejtues;
- I pranon nga zyrtari i protokollit shkresat dhe aktet e tjera drejtuar KD-së dhe ua përcjell ato kryetarit, zëvendëskryetarit dhe sekretarit të përgjithshëm të Universitetit;
- Përpilon vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e miratuara në Këshillin Drejtues;
- Merr pjesë në përgatitjen e mbledhjeve dhe përpilon shkresa të cilat i dërgon Këshilli Drejtues;
- I kryen të gjitha punët administrative dhe profesionale të cilat lidhen me fushëveprimin e Këshillit Drejtues;
- Përgatit dokumentacionin e aplikantëve për bursa të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe për lirim nga pagesa e semestrave për shqyrtim nga komisionet përkatëse;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)**II. Nëpunësi mbikëqyrës:**

Kryetarit të KD-së dhe Drejtorit të zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti shkencat shoqërore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P**1.5 Asistent ekzekutiv i zyrës së Rektorit****I. Detyrat – përgjegjësitë:**

- E koordinon punën në zyrën e rektorit dhe përgatit dokumentacion të nevojshëm për takime, udhëtime zyrtare etj;
- I regjistron takimet, thirrjet telefonike nga brenda dhe jashtë vendi, si dhe e mban adresarin (numrat) e telefonave të rektorit, prorektorëve dhe të personelit në Universitet; kujdeset që telefonat të përdoren vetëm për nevoja zyrtare;
- I mirëpret vizitorët dhe bashkëbiseduesit në telefon, i përcjell mesazhet nga rektori, nga prorektorët dhe nga udhëheqësit e tjerë të Universitetit dhe i pranon ato për rektorin, për prorektorët dhe për udhëheqësit e tjerë të UHZ-së;
- Sipas nevojës merr pjesë në takimet e rektorit për përkthim nga shqipja në anglisht dhe anasjelltas.
- Merr pjesë në përgatitjen e mbledhjeve dhe konferencave, duke përfshirë këtu edhe prenotimet hoteliere;
- I informon fakultetet për takimet e Senatit, të Bordit dhe për takimet e tjera që organizohen në Universitet;
- Përkujdeset dhe përgjigjet për ruajtjen e sekretit zyrtar në çështjet e Universitetit;

- Përgatit raportet, memorandumet, dhe të gjitha dokumentet dhe formularët e tjerë të Universitetit që ndërlidhen me çështjet operuese të Universitetit dhe Rektorit; i përcjell dokumentet e Universitetit për nënshkrim dhe i ruan ato;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Rektorit dhe Drejtorit të zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Diplomë Universitare në Biznes, Menaxhment, Inxhiniering, Administrim Publik, Juridik apo në ndonjë fushë relevante;

IV. Përvoja e përgjithshme:

Dy vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

III. Zyrat e Administratës Qendrore

1. Zyra e auditimit të brendshëm

1.1. Drejtor i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për organizimin, kryerjen, mbikëqyrjen dhe ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm, si dhe për dorëzimin e rezultateve të auditimit të menaxhmenti i lartë;
- Është përgjegjës për përzgjedhjen e auditorëve të brendshëm në baza konkurruese, pas konsultimit nga lista e auditorëve të brendshëm e siguruar nga NJQH dhe në pajtim me ligjet e tjera të zbatueshme në Kosovë, legjisacionin për shërbimin civil;
- Është përgjegjës për të siguruar zbatimin adekuat dhe respektimin e ligjeve, rregullave, politikave, udhëzimeve dhe doracakëve të përcaktuar me Ligjin mbi Auditimin e Brendshëm;
- Është përgjegjës për të siguruar përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të planit strategjik të auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut për rishikim dhe miratim të menaxhmenti i lartë;
- Është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve tremujore dhe vjetore për të gjitha aktivitetet e auditimit të menaxhmenti i lartë;
- Merr informata të certifikuara nga Thesari, Banka Qendrore e Kosovës dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhironlogaritë dhe/ose transaksionet aktuale ose të mbyllura që përfshijnë subjektet mbi të cilat Zyra për auditim të brendshëm ka kompetenca sipas nenit 10.1 të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm;
- I mirëmban të gjitha dosjet e raporteve të auditimit, shënimet gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet, dëshmitë që kanë të bëjnë me ato raporte dhe me të gjitha rekomandimet e dhëna menaxhmenti i lartë, të cilat duhet të ruhen së paku 7 (shtatë) vjet;
- Është përgjegjës për raportimin e menjëhershëm të menaxhmenti i lartë për çdo indikator të aktivitetit të mashtrimit apo korrupsionit dhe dhënien e propozimeve për përmirësimin e sistemeve, si dhe njoftimin e autoriteteve kompetente, nëse menaxhmenti i lartë nuk ndërmer veprime të duhura;
- Është përgjegjës për përgatitjen e një plani për të siguruar zhvillimin e mjaftueshëm profesional të të gjithë anëtarëve të Zyrës së auditimit të brendshëm, përfshirë edhe udhëheqësin i zyrës;

- Është përgjegjës për t'i dorëzuar menaxhmenti të lartë statutin për funksionin e Auditimit të brendshëm, i bazuar në modelin e siguruar nga NJQHAB-ja;
- Udhëheqësi i zyrës njëkohësisht duhet të jetë edhe auditor i brendshëm;
- Është përgjegjës dhe kryen detyra të tjera të parapara me nenin 12 dhe 14 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Rektori dhe Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – ekonomist ose jurist i diplomuar, licencë ose certifikatë të vlefshme për auditim të brendshëm të lëshuar nga organi kompetent, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

1.1.1 Zyrtar i auditimit të brendshëm

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Bën auditime të brendshme në UHZ, në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, statutin e auditimit të brendshëm, kodin e etikës dhe standardet profesionale të miratuara nga ministri, sipas nenit 7.4 të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm;
- I merr, i shqyrton dhe i shfrytëzon pa kufizim të gjitha të dhënat teknike, ekonomike, financiare, si dhe informatat e dokumentet e UHZ-së që auditohen;
- Kërkon nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar ose kontraktues i UHZ-së që të ofrojë dëshmi fizike, shënime dhe dëshmi gojore ose informata të tjera për çështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose për aktivitetet që janë nën auditim;
- Verifikon dhe vlerëson vlera monetare të pasurisë së UHZ-së në pajtim me rregullat dhe legjislacionin;
- Raporton te menaxhmenti i lartë për të gjitha çështjet materiale të lidhura me kryerjen e auditimit të brendshëm dhe me rezultatet e tij;
- Merr informata të certifikuara nga Thesari, Banka Qendrore e Kosovës dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhirologaritë dhe/ose transaksionet aktuale ose të mbyllura që përfshijnë subjektet për të cilat Zyra e auditimit të brendshëm ka kompetenca sipas nenit 10.1 të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm;
- Është përgjegjës për raportimin e menjëhershëm te menaxhmenti i lartë për çdo indikator të aktivitetit të mashtrimit apo korrupsionit dhe për dhënien e propozimeve për përmirësimin e sistemeve, si dhe njoftimin e autoriteteve kompetente, nëse menaxhmenti i lartë nuk ndërmer veprime të duhura;
- I mirëmban dosjet e raporteve të auditimit, shënimet gjithëpërfshirëse të shkruara në lidhje me të gjitha çështjet, dëshmitë që kanë të bëjnë me ato raporte dhe të gjitha rekomandimet e dhëna menaxhmenti të lartë, të cilat duhet të ruhen së paku 7 (shtatë) vjet;
- Është përgjegjës dhe kryen detyra të tjera të parapara me nenin 12 dhe 14 të Ligjit për Auditimin e Brendshëm.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtorit të zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – ekonomist ose jurist i diplomuar, licencë ose certifikatë të vlefshme për auditim të brendshëm të lëshuar nga organi kompetent, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

2. Zyra e Administratës për Shërbime të Përgjithshme

2.1. Drejtor i Zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E bën administrimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e zyrës për personel dhe administratë, duke siguruar se funksionet e caktuara përmbushen në mënyrë efektive dhe efikase;
- I mbikëqyr dhe siguron që çështjet administrative në UHZ zbatohen brenda afateve kohore dhe në mënyrë efikase;
- Përgatitë rekomandime për ndryshime transferim apo për zhvillim të strukturës organizative të zyrave administrative në UHZ;
- I shqyrton kërkesat e propozuara dhe të paraqitura nga zyrat administrative;
- Në mënyrë aktive bashkëpunon me zyrtarët e lartë të të gjithë sektorëve dhe me zyrat administrative të njësive akademike
- Kryen funksionin e menaxherit të personelit sipas akteve ligjore të Shërbyesve Civil;
- Menaxhon me mbajtjen dhe azhurnimin e dosjeve të personelit sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil dhe akteve nënligjore, si dhe e mban librin e amzës së personelit të punësuar;
- E këshillon autoritetin punëdhënës dhe stafin menaxhues për procedurat e rekrutimit, të vlerësimit, të përshkrimit të vendeve të punës dhe të të gjitha procedurave të tjera të parapara me LSHC;
- Harton – përgatit kontrata të punës për personelin administrativ, profesional dhe teknik të Universitetit;
- Këshillon dhe vepron për çështje disiplinore në përputhje me rregullat dhe procedurat e caktuara, si dhe lëshon vërtetime dhe dokumente të tjera lidhur me statusin e personelit;
- Kryen edhe detyra të tjera nga fushë veprimtaria e Zyrës për administratë dhe me kërkesën e sekretarit të përgjithshëm.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti ose Master, në fushat Juridik ose Administratë Publike, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

2.1.1 Zyrtar për Ndërtime

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;

- Harton procedurat dhe ndihmon zyrtarët në lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcaktimin e kushteve urbanistike për zbatimin e planit urbanistik, planit të rregullimit, planit të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit;
- Mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit, procedurave dhe standardeve lidhur me ndërtimet si dhe siguron zbatimin e programit për rregullimin e tokës ndërtimore;
- Organizon dhe merr pjesë në komisionin për pranime teknike të objekteve ndërtimore dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Këshillon për sigurimin e dokumentacionit të nevojshme për kryerjen e ndërtimit dhe banimit;
- Siguron mbajtjen e rregullt të protokolleve të ndërtimit dhe në raste të caktuara del në terren për shikim dhe incizim të gjendjes faktike;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretarit të përgjithshëm dhe Drejtorit të zyrës për administratë dhe shërbime të përgjithshme

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Diploma universitare-Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës ; e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

3. Zyra për marrëdhënie me publikun

3.1 Drejtor i Zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I koordinon aktivitetet e Universitetit në relacion me mediat dhe informimin e brendshëm;
- I trajton pyetjet e publikut dhe kërkesat zyrtare për informata lidhur me punën e Universitetit, në konsultim me prorektorin për bashkëpunim ndërkombëtar dhe me sekretarin e përgjithshëm;
- Mban korrespondencë dhe përgjigjet në kërkesat dhe pyetjet e studentëve dhe të personave të tjerë nëpërmjet ueb-faqes së Universitetit;
- I trajton pyetjet që ndërlidhen me Universitetin dhe shërben si zëdhënës i Universitetit;
- I menaxhon dhe i organizon kontaktet me media për përgatitje të nevojshme të konferencave dhe të vizitave të ndryshme;
- Përgatit komunikata për media, deklarata për shtyp dhe materiale të tjera relevante për publikim, si dhe e zhvillon dhe e mirëmban sipas datës arkivin e shtypit, informatat publike, artikujt e tjerë të publikuar në shtyp, të cilët kanë të bëjnë me Universitetin;
- Në bashkëpunim me asistentët dhe zyrtarët e tjerë e udhëheq protokollin për pritjen e mysafirëve të Universitetit;
- Përgatit informata për shtyp ose për nevoja të tjera të Universitetit;
- Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së sekretarit të përgjithshëm.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Rektori i UHZ-së, sekretari i përgjithshëm

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

3.1.1 Zyrtar për Mardhënie me Publikun

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I koordinon aktivitetet e Universitetit në relacion me mediat dhe informimin e brendshëm;
- I trajton pyetjet e publikut dhe kërkesat zyrtare për informata lidhur me punën e Universitetit, në konsultim me prorektorin për bashkëpunim ndërkombëtar dhe me sekretarin e përgjithshëm;
- Mban korrespondencë dhe përgjigjet në kërkesat dhe pyetjet e studentëve dhe të personave të tjerë nëpërmjet ueb-faqes së Universitetit;
- I trajton pyetjet që ndërlidhen me Universitetin dhe shërben si zëdhënës i Universitetit;
- I menaxhon dhe i organizon kontaktet me media për përgatitje të nevojshme të konferencave dhe të vizitave të ndryshme;
- Përgatit komunikata për media, deklarata për shtyp dhe materiale të tjera relevante për publikim, si dhe e zhvillon dhe e mirëmban sipas datës arkivin e shtypit, informatat publike, artikujt e tjerë të publikuar në shtyp, të cilët kanë të bëjnë me Universitetin;
- Në bashkëpunim me asistentët dhe zyrtarët e tjerë e udhëheq protokollin për pritjen e mysafirëve të Universitetit;
- Përgatit informata për shtyp ose për nevoja të tjera të Universitetit;
- Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së sekretarit të përgjithshëm.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtorit të Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

4. Zyra për Çështje Akadematike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie

4.1 Drejtor i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Organizon dhe koordinon punën e zyrës për Çështje Akadematike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie;
- Përgatit kontratat e punës për stafin akademik të rregullt dhe të angazhuar të universitetit;
- Përpilon informata, analiza dhe raporte të ndryshme statistikore për personelin akademik të Universitetit dhe për nevoja të Universitetit, si dhe i azhurnon të dhënat për personelin;
- Përpilon informata dhe bashkëpunon me fakultetet lidhur me publikimin dhe realizimin e konkursit për personelin akademik të Universitetit;
- I përpilon pasqyrat e llogaritjes se orëve mbi normë dhe honorar, në bazë të propozimeve të fakulteteve për angazhimin e personelit akademik;
- Bënë përgatitjen e materialit për mbledhjet e Komisionit të studimeve, Këshillit qendror të studimeve të doktoratës, Senatit të Universitetit, në të cilat trajtohen çështje akademike dhe Përsosmëri në mësimdhënie;

- Kryen punë në koordinimin me Senatën e UHZ-së, Këshillin Drejtues, Njësitë Akadematike, Institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e mësimdhënies, çështjeve akademike dhe çështjet e ndërlidhura;
- Nën udhëheqjen e Prorektorit për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore, e përpilon planin e punës së Zyrës dhe e mbikëqyr realizimin e tij;
- Identifikon nevojën për fushat e trajnimit të stafit akademik në koordinim me prorektorin për çështje akademike dhe dekanët e njësive akademike;
- Përmes zyrës për Çështje Akadematike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie organizohen trajnime që do të ndihmojnë zhvillimin profesional të stafit akademik të UHZ-së. Monitoron zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit nga ana e stafit akademik;
- Në bashkëpunim me menaxhmentin, njësitë akademike dhe me stafin akademik do të hartojnë plane dhe do të realizojnë trajnime e aktivitete të tjera në funksion të promovimit e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit;
- Ofron mbështetje individuale stafit akademik për planifikimin e zhvillimit e tyre profesional respektivisht në hartimin e planeve individuale zhvillimore për periudhën një vjeçare;
- Në baza vjetore do të bëjë identifikimin e nevojave të stafit akademik për zhvillim profesional të stafit akademik, përkatësisht për trajnime në funksion të zotërimit dhe zbatimin të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit nga ana e stafit akademik;
- Zyra për Çështje Akadematike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie në bashkëpunim me Prorektorin për Mësimdhënie dhe me Dekanët e fakulteteve do të organizojë monitorim të stafit akademik në lidhje me zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit;
- Në koordinim me menaxhmentin Zyra për Çështje Akadematike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie organizon monitorime të rregullta së paku një herë në vit për secilin mësimdhënës, monitorime "ad-hoc" në raste të ankesave, si dhe monitorim me rastin e avancimit të personelit akademik;
- Përgatit statistika për nivelin e implementimit të metodave bashkëkohore nga mësimdhënies dhe të vlerësimit, si dhe do ta përkrahë stafin akademik në këtë drejtim përmes aktiviteteve që do të organizohen nga menaxhmenti i UHZ - së;

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm dhe Prorektorit për Mësimdhënie, Kërkime Shkencore dhe Çështje Studentore

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – master ose i diplomuar në Fakultetin Juridik, Ekonomik Filozofik ose të Filologjisë, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

4.1.1 Zyrtar për Përsosmëri në Mësimdhënie

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me Drejtorin e zyrës, do të hartojnë plane dhe do të realizojnë trajnime e aktivitete të tjera në funksion të promovimit e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit;
- Ofron mbështetje individuale stafit akademik për planifikimin e zhvillimit e tyre profesional respektivisht në hartimin e planeve individuale zhvillimore për periudhën një vjeçare;
- Në baza vjetore do të bëjë identifikimin e nevojave të stafit akademik për zhvillim profesional të stafit akademik, përkatësisht për trajnime në funksion të zotërimit dhe

zbatimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit nga ana e stafit akademik;

- Përmes zyrës për Çështje Akademike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie organizohen trajnime që do të ndihmojnë zhvillimin profesional të stafit akademik të UHZ-së. Monitoron zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit nga ana e stafit akademik;
- Zyra për Çështje Akademike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie në bashkëpunim me Prorektorin për Mësimdhënie dhe me Dekanët e fakulteteve do të organizojë monitorim të stafit akademik në lidhje me zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit;
- Në koordinim më menaxhmenit Zyra për Çështje Akademike dhe Përsosmëri në Mësimdhënie organizon monitorime të rregullta së paku një herë në vit për secilin mësimdhënës, monitorime "ad-hoc" në raste të ankesave, si dhe monitorim me rastin e avancimit të personelit akademik;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi.

Numri i posteve: Dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

4.1.2 Zyrar për çështje akademike

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E përcjell dhe kujdeset për planin dhe veprimtarinë botuese të Universitetit, i përgatit materialet për mbledhjet e Këshillit botues të UHZ-së, mban procesverbal në mbledhje, përpilon vendime, shkresa dhe njoftime për palët sipas vendimeve të KB-së;
- I përgatit materialet për mbledhjet e Këshillit qendror për studime të doktoratës në UHZ, mban procesverbal në mbledhje, përpilon vendime, shkresa dhe njoftime për palët sipas vendimeve të KQSD-së;
- E verifikon dokumentacionin dhe i përgatit për Senat pasqyrat e kandidatëve për lejim të temës ose ratifikim të disertacionit nga Senati, sipas vendimeve të Senatit përpilon vendime për kandidatët për lejim të temës ose ratifikim të disertacionit, i përcjell studimet e doktoratës dhe e mirëmban dokumentacionin për secilin kandidat, përgatit pasqyra me shënime përkatëse, nxjerr statistika në bazë të viteve, fakulteteve dhe gjinisë;
- Mban evidencën përkatëse në librin e amzës së doktorëve të shkencave, përgatit shkresa dhe njoftime për dekanët dhe kandidatët, i verifikon dhe i përgatit shënime për diploma, e përgatit ceremoninë e promovimit;
- Mban evidencë zyrtare përkatëse në librin e amzës së "Doctor Honoris Causa i UHZ-së" dhe ndihmon në përgatitjen e ceremonisë për ndarjen e titullit "DHC i UHZ-së". Gjithashtu, përkujdeset për veshjet akademike të rektorit dhe të dekanëve, si dhe për gjerdanët;
- I përgatit, sipas fakulteteve dhe vitit të lindjes, pasqyrat e personelit akademik që i plotëson së afërmi kushtet për pension, i përcjell ndryshimet në pasqyra.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

5. Zyra për Kërkime Shkencore

5.1 Drejtor i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Organiza dhe koordinon punën e zyrës për Kërkime Shkencore;
- Përpilon informata, analiza dhe raporte të ndryshme statistikore për nevoja të Universitetit, lidhur me publikimet dhe punimet shkencore, si dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore të stafit akademik;
- Zyra për Kërkime Shkencore në bashkëpunim me Prorektorin për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore në vazhdimësi do të përcjell publikimet e stafit akademik të universitetit;
- Harton dhe rifreskon databazën e publikimeve shkencore për stafit akademik të universitetit;
- Punon duke u këshilluar me menaxhmentin e UHZ-së, përkatësisht me Prorektorin për mësimdhënie, çështje studentore dhe kërkime shkencore, si dhe me akteret e tjerë relevant për të përkrahur promovimin dhe zbatimin e rekomandimeve që dalin nga Procesi i Bolonjës në UHZ;
- Kryen punë në koordinim me Senatin e UHZ-së, Këshillin Drejtues, Njësitë Akadematike, Institutet, si dhe me këshillat, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura;
- Përgatitë materialin për mbledhjet e Këshillit të Botimeve;
- Harton dhe rifreskon në vazhdimësi databazën për botime të stafit akademik në UHZ;
- Bënë përgatitjen e materialit për mbledhjet e Komisionit të studimeve, Këshillit qendror të studimeve të doktoratës, Këshillit botues dhe Senatit të Universitetit, në të cilat trajtohen kërkimet shkencore;

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm dhe Prorektorit për Mësimdhënie, Kërkime Shkencore dhe Çështje Studentore

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – master ose i diplomuar në Fakultetin Juridik, Ekonomik Filozofik ose të Filologjisë, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

5.1.1 Zyrtar për Kërkime Shkencore

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Përgatitë materialet për mbledhjet me këshill, komisionet dhe grupet punuese në sektorin e kërkimeve shkencore dhe çështjet e ndërlidhura;
- Mban procesverbal në mbledhje, përpilon vendime, shkresa dhe njoftime për palët sipas vendimeve përkatëse;
- Bënë postimin tek faqja zyrtare UHZ të materialeve informuese dhe dokumenteve të nevojshme që ndërlidhen me veprimtaritë kërkimore shkencore/artistike;

- Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Zyrës, shpërndan njoftime dhe ftesa tek njësitë akademike lidhur me veprimtaritë kërkimore shkencore/artistike në UHZ dhe jashtë saj.
- Bënë regjistrimin e të dhënave lidhur me projektet kërkimore shkencore/artistike për njësi akademike, në databazën e UHZ-së për veprimtari kërkimore shkencore/artistike.
- Ofron mbështetje teknike dhe administrative stafit akademik në procesin e aplikimit në projekte kërkimore shkencore/artistike.
- E njofton stafin dhe hulumtuesit e rinj për mundësinë e publikimit të punës së tyre shkencore në forume dhe revista të karakterit kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Merr pjesë në hartimin e materialeve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me hulumtime shkencore dhe e koordinon zbatimin e tyre (strategjia për shkencë, broshura etj.);
- Kryen aktivitete lidhur me hulumtimet shkencore;
- Ofron këshilla, udhëzime dhe shërbime të përshtatshme për stafin akademik në zhvillimin e projekteve hulumtuese (p.sh. informimi për fondet e donatorëve, çështjet ligjore, bashkëpunimet e mundshme me komunitetin e biznesit etj.);
- Shërben si person kontaktues në UHZ për projektet e karakterit hulumtues shkencor, si FP7, IPA, "MarieCurie" etj;
- Nxjerr raporte për punën shkencore në Universitet;
- Kryen punë të tjera të cilat ia cakton nëpunësi mbikëqyrës.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

6. Zyra për Çështje Studentore

6.1 Drejtor i Zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Organizon, koordinon punën me Menaxhmentin e UHZ-së, propozimet e Njësive Akademike për numrin e studentëve që do t'i regjistrojnë në vitin vijues akademik dhe të njëjtat i'a dërgon Senatit për miratim;
- Organizon dhe përgatitë dinamikën e realizimit të konkursit dhe planin e angazhimit të zyrtarëve të sektorit për çështje të studentëve dhe personave të tjerë në regjistrimin e studentëve të rinj;
- I bën përgatitjet e nevojshme teknike dhe regjistrimin e studenteve në vitin e parë të studimeve;
- I informon fakultetet për studentët e regjistruar dhe për ata që nuk janë regjistruar;
- Pas përfundimit të konkursit, e harton raportin përfundimtar - pasqyrat e studentëve të regjistruar në vitin e parë të studimeve;
- Lëshon vërtetime lidhur me regjistrimin e studentëve dhe statusin e studentit;
- E përgatit dhe kujdeset për publikimin e "Informatorit për studentët e rinj" dhe për shpërndarjen e tij nëpër Njësi Akademike;
- Menaxhon dhe përgatitë statistikën për numrin e përgjithshëm të studentëve në të gjitha nivelet e studimeve.
- Përgatitë diplomat, verifikon dhe mban librin amëz për studentët e pajisur me diploma.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm dhe Prorektori për Mësimdhënie, Kërkime Shkencore dhe Çështje Studentore

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

6.1.1 Zyrtar i për shërbime të studentëve

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Bën regjistrimin e studentëve të pranuar sipas regjistrave të fakulteteve, e cakton numrin e amzës së studentit, në bazë të të cilit hartohen listat e studentëve sipas fakulteteve, departamenteve - degëve dhe drejtimeve;
- E rregullon dokumentacionin e studentëve të pranuar sipas numrit të indekseve dhe i formon dosjet e tyre;
- I regjistron të dhënat e studentëve të UHZ në programin përkatës kompjuterik;
- Merr pjesë në përgatitjen e konkursit për regjistrimin e studentëve të rinj, në hartimin e dinamikës dhe përgatitjet për regjistrimin e studentëve të rinj;
- Pas regjistrimit të studentëve, për çdo afat të konkursit, i përgatit pasqyrat e studentëve të regjistruar dhe të atyre që nuk janë regjistruar;
- Lëshon vërtetime lidhur me regjistrimin e studentëve dhe statusin e studentit;
- Kryen punë të tjera të cilat ia cakton nëpunësi mbikëqyrës.

Numri i posteve: një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Një vit përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

6.1.2 Zyrtar për diploma

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E bën futjen e shënimeve në kompjuter për kandidatët e diplomuar në Universitet;
- E mban librin e amzës për numrin e të diplomuarve;
- Nëpërmjet kompjuterit i plotëson formularët e diplomës për kandidatët e diplomuar në studimet themelore baçelor dhe në master, si dhe i shpërndan ato;
- Mban evidencë të saktë dhe shtyp diploma në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Raporton në Zyrën për buxhet dhe financa për t'i barazuar në baza mujore të hyrat të cilat krijohen nga shtypja e diplomave;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Dy vite përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

7. Biblioteka Qendrore Universitare dhe Struktura Organizative

7.1 Drejtor i Zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

Biblioteka Qendrore është zyre në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Bibliotekës Universitare janë të përcaktuara me nenin 79, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë:

- Biblioteka Qendrore Universitare mbledhë, përpunon dhe ofron në përdorim koleksione mësimore, materiale, informacione dhe shërbime bibliotekare për zhvillimin e veprimtarisë arsimore, shkencore si dhe për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të studentëve e mësimdhënësve të tyre;
- Biblioteka Qendrore Universitare ofron shërbime për studentët dhe personelin mësimor duke i'u dhënë në huazim materiale bibliotekare dhe duke siguruar qasje në burimet elektronike të informacionit. Ofron shërbime profesionale për bibliotekat e fakulteteve përkatëse. Veprimtaria e bibliotekave universitare mbështetët në standardet ndërkombëtare bibliotekare;
- Biblioteka Qendrore Universitare është pjesë përbërëse e Rrjetit të njësuar Bibliotekar të Kosovës me qëllim të zbatimit të standardeve bibliotekare, përgatitjes dhe shpërndarjes së bazës së të dhënave dhe begatimit e bashkërenditjes së bashkëpunimit ndërbibliotekar.
- Drejtori i Bibliotekës Universitare i raporton në aspektin operacional të Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa për çështjet profesionale që lidhen me detyrat e punës raporton dhe i koordinon punët me Prorektorin për Mësimdhënie, Çështje Studentore dhe Kërkime Shkencore
- Struktura organizative e BQU-së përcaktohet në përputhje me nevojat e BQU-së sipas standardeve ndërkombëtare për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore ndaj lexuesve;
- Në strukturën e BQU-së përfshihen Sektorët, Shërbimet dhe Zyrat.
- Me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm të BQU-së (Organogram), përcaktohet veprimtaria e zyrave, mënyra e udhëheqjes, mënyra e kryerjes së punëve dhe detyrave, si dhe të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në BQU.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm dhe Prorektorit për Mësimdhënie, Kërkime Shkencore dhe Çështje Studentore

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

7.1.1 Bibliotekar

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E organizon punën në Bibliotekën e Fakultetit sipas nomenklaturës që aplikohet;
- E hulumton bazën e të dhënave shkencore teknologjike;
- Kryen edhe punë të tjera të ngjashme sipas urdhrave të dekanit dhe të sekretarit të Fakultetit;
- I kryen të gjitha punët e regjistrimit të librave, broshurave dhe revistave në Bibliotekë;

- E rregullon Bibliotekën sipas nomenklaturës që aplikohet;
- U jep libra për shfrytëzim studentëve, mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve;
- Sipas nevojës, bën kujdestari në sallën e leximit të studentëve;
- Kryen edhe punë të tjera të ngjashme sipas urdhrave të dekanit dhe të sekretarit të Fakultetit.

Numri i posteve: Dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtorit të Bibliotekës dhe sekretari i Fakultetit.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti i shkencave shoqërore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Një vit përvojë pune të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

8. Zyra për Buxhet dhe Financa

8.1. Drejtori zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E përgatit propozimin e buxhetit, i përpilon kërkesat e nevojshme për Universitetin "Haxhi Zeka" si organizatë buxhetore dhe këto i dorëzon për përvetësime në MEF;
- E koordinon punën me të gjitha zyrat e njësive akademike të UHZ-së për përpunimin e matricave për buxhetin e UHZ-së; i harmonizon kërkesat e njësive akademike të UHZ-së me kufirin fillestar të përcaktuar nga MEF-i;
- I fut të dhënat fillestare në sistemin e BDMS-së: kërkesat fillestare të njësive pas harmonizimit në nivel të UHZ-së, numrin e të punësuarve sipas formularëve, shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve sipas kategorive dhe kodeve të përcaktuara nga Thesari, shpenzimet komunale, transferimet dhe subvencionet, shpenzimet kapitale etj.;
- I fut projektet kapitale të propozuara dhe të llogaritura nga njësitë organizative të UHZ-së në sistemin e PIP-it, llogarit sipas formave të përcaktuara nga MEF-i për projekte kapitale;
- E planifikon dhe e përpilon planin e CASH-it për UHZ-në pas miratimit të buxhetit dhe e dorëzon në MEF-Thesar; bën kërkesa për alokimin e mjeteve nga Thesari sipas periodave tremujore;
- I përcjell zotimet e mjeteve sipas planifikimit me buxhet dhe sipas planit të CASH-it të kërkuar nga UHZ-ja, respektivisht nga njësitë akademike të UHZ-së;
- E bën rishikimin e buxhetit dhe harmonizimin i tij me rebalancin;
- Përgatit pasqyra financiare për MEF-in, përgatit raporte periodike dhe vjetore për Këshillin Drejtues të UHZ-së dhe për MEF-in;
- Bën planifikimin e të hyrave vetjake sipas MIM-it për inkasimin e të hyrave vetjake nga njësitë akademike dhe planifikimin për shpërndarje dhe realizim të mjeteve sipas MIM;
- Zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave dhe procedurave buxhetore dhe financiare në shërbimin përkatës;
- Kryen edhe detyra të tjera që kërkohen nga menaxhmenti i UHZ-së.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së dhe Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – master ose Fakulteti Ekonomik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

8.1.1 Zyrtar për shpenzime

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Bën verifikimin e UZP-së dhe siguron që zotimi është regjistruar në SIMFK;
- Bën verifikimin e deponimit të nënshkrimeve nga zyrtarët përkatës të autorizuar;
- Bën kontrollimin e karakterit ekonomik të shpenzimeve në bazë të dokumentacionit përcjellës;
- Bën kontrollimin e emrit të përfituesit dhe llogarisë bankare në sistem, apo SËIFT-kodin në rastin e pagesave ndërkombëtare në bazë të dokumentacionit përcjellës;
- Bën regjistrimin e kuponit të shpenzimeve në SIMFK;
- E përcjell dokumentacionin e plotë financiar te zyrtari i certifikuar për certifikim dhe aprovim në SIMFK;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

8.1.2 Zyrtar për të hyra

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I përcjell të gjitha të hyrat e krijuara në UHZ, d.m.th. në të gjitha njësitë akademike;
- I barazon të hyrat për çdo muaj me BQK-në dhe Thesarin;
- I barazon të hyrat me të gjitha njësitë akademike të UHZ-së;
- I barazon të hyrat e instituteve, si dhe të hyrat e tjera;
- Raporton për të gjitha të hyrat te udhëheqësi i zyrës;
- I alokon të hyrat sipas kërkesës së zyrtarit të lartë, si dhe në bazë të ligjit dhe rregullave financiare në bashkëpunim me zyrtarin e buxhetit, zyrtarin e lartë dhe zyrtarin e pagave;
- I përcjell fakultet se sa janë duke i zbatuar udhëzimet dhe Statutin e UHZ-së, të cilat i precizojnë pagesat e studentëve siç janë të parapara;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

8.1.3 Zyrtar për zotime dhe buxhet

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I pranon dhe i zoton mjetet në bazë të planifikimit dhe kërkesave të fakulteteve;
- Bën zotimin e të gjitha mjeteve në nivel të UHZ-së në bazë të planifikimit të buxhetit;
- Raporton te udhëheqësi i zyrës për zotimet dhe siguron informata për çdo ditë pune nga SIMFK-ja për ecurinë e shfrytëzimit të buxhetit;

- I përcjell fakultetet gjatë shpenzimit të buxhetit, si dhe bën krahasimin se a është duke u shpenzuar buxheti në bazë të planifikimit dhe ligjeve në fuqi;
- I përcjell projektet kapitale sipas dinamikës;
- E ndihmon udhëheqësin i zyrës për harmonizimin e kërkesave buxhetore;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

8.1.4 Zyrtar për paga

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I përcjell të gjitha pagat në UHZ;
- I fut në sistem pagat e punëtorëve të rinj;
- E përcjell për çdo muaj se sa është vlera e pagave në UHZ, e informon zyrtarin e buxhetit dhe i raporton zyrtarit të lartë;
- I heq nga sistemi i pagave punëtorët e pensionuar dhe të larguar, ose ata që u ka skaduar kontrata në bazë të ligjit;
- Komunikon me Departamentin e Pagave në MAP për llogaritjen e pagave të UHZ-së;
- Bën pagesën e honorarëve të stafit akademik në bazë të kontratave dhe raporteve të fakulteteve;
- Bën llogaritjen e stimulimit për stafin administrativ të UHZ-së në bazë të Rregullores për të ardhurat personale;
- Bën llogaritjen e shtesave të stafit akademik të UHZ-së në bazë të raporteve të fakulteteve, si dhe në bazë të rregullores për të ardhura personale, d.m.th. i bën të gjitha pagesat që janë të parapara me rregulloren për të ardhura personale në UHZ;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton nëpunësi mbikëqyrës.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

8.1.5 Zyrtar për asete

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I përcjell të gjitha pasuritë e UHZ-së dhe e regjistron inventarin në Rektorat dhe në AQ;
- E bën përcjelljen e regjistrimeve të inventarit të të gjitha njësive akademike;
- I regjistron në SIMFK të gjitha pasuritë me vlerë kapitale mbi 1000 euro në kuadër të UHZ-së;
- E bën ngarkimin dhe shkarkimin e zyrtarëve sipas lëvizjeve nëpër zyra dhe kërkesave të menaxhmentit;

- I raportojnë fakultetet për regjistrimin e inventarit dhe të pasurisë sipas proceduarave ligjore;
- I monitoron njësitë akademike lidhur me regjistrimin e pasurisë dhe të inventarit sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- E amortizon për çdo vit fiskal gjithë inventarin e UHZ-së në bazë të Ligjit, si dhe raporton për inventarin që është jashtë përdorimit;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

8.1.6 Arkëtar

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E mban paranë e imët në Rektorat;
- I siguron të gjitha avancet për udhëtime zyrtare të menaxhmentit të UHZ-së;
- E tërheq për të gjitha fakultetet paranë e imët (petycash) dhe avancet;
- I përcjell se a janë shpenzuar të gjitha avancet dhe paratë e imëta në bazë të rregullave financiare të Thesarit dhe Rregulloreve të Brendshme të UHZ-së;
- Raporton për çdo muaj për shpenzimet e parës së imët dhe për avance, si dhe menaxhimin e tyre në bazë të ligjit;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

9. Zyra e Prokurimit

9.1. Drejtor i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Është përgjegjës kryesor për organizimin dhe funksionimin e mirëfilltë të procesit të prokurimit, jep këshilla, sugjerime profesionale në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit për zyrtarët e prokurimit brenda zyrës dhe sipas nevojës edhe për zyrtarët e tjerë kur kërkohet;
- Bashkëpunon me udhëheqësit e të gjitha zyrave brenda UHZ-së, me qëllim të hartimit të planit strategjik të prokurimit për UHZ-në;
- I koordinon dhe i menaxhon projektet e prokurimit dhe siguron që të gjitha procedurat dhe aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në pajtim me ligjin që i rregullon procedurat e prokurimit në Kosovë;

- E koordinon punën mes njërive dhe siguron se të gjitha kërkesat për prokurim për mallra, shërbime, punë apo shërbime konsulente janë në rregull dhe të nënshkuara nga personat përgjegjës dhe se janë në harmoni me procedurat e prokurimit;
- Është përgjegjës për caktimin e metodave të prokurimit, për procedurat e tenderit dhe për kuotimin e çmimeve;
- Koordinohet me zyrtarin kryesor administrativ në lëmin e prokurimit dhe është personi kontaktues mes UHZ-së dhe Komisionin Rregullativ të Prokurimit lidhur me realizimin e kontratave nga kontraktuesit e ndryshëm;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton nëpunësi mbikëqyrës.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së dhe Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – ekonomist, jurist i diplomuar ose master në Fakultetin Ekonomik ose Juridik dhe i certifikuar nga KRPP dhe nga MEF – Departamenti i Thesarit për prokurim me modul të blerjeve, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

9.1.1 Zyrtar i Prokurimit

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Bën përgatitjen e materialeve standarde, varësisht nga metoda e prokurimit;
- Bën përgatitjen e ftesave për ofertë-tender, i dërgon për shpallje në mjetet e informimit dhe i shpërndan ftesat për oferta për blerjen konkurruese;
- Siguron që të gjitha kërkesat për prokurim për mallra dhe shërbime të jenë të nënshkuara nga personat e autorizuar;
- Bën pranimin e materialit tenderues në listë dhe i regjistron të gjitha kompanitë që marrin materialin e tenderit të hartuar për këtë qëllim;
- I pranon të gjitha pyetjet dhe u përgjigjet të gjitha kompanive lidhur me materialin e tenderit, si dhe pranon oferta nga kompanitë në kohën e paraparë në tender;
- Me mbarimin e procesit të vlerësimit, e përgatit dokumentacionin e nevojshëm dhe e bën kompletimin e dokumentacionit për aprovim;
- Asiston në monitorimin dhe ekzekutimin-(realizimin) e kontratës dhe raporton për mosrealizimin e kontratave;
- E bën kontrollimin e faturave në pajtim me kushtet e kontratës, me shënime për mallrat e pranuar të nënshkuara nga nëpunësi për pranimin e mallrave, e përgatit dokumentacionin për pagesë në Financa;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik ose Fakulteti Juridik dhe i certifikuar nga KRPP dhe nga MEF–Departamenti i Thesarit për prokurim me modul të blerjeve, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

10. Zyra e Teknologjisë së Informacionit

10.1 Drejtor i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe vendos standarde për rregulloret në lidhje me: harduerin, softuerin, rrjetin akademik dhe qendrën e të dhënave në UHZ;
- Planifikon dhe propozon projekte për nevojat e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë (UHZ) për teknologji informacioni (TI);
- I shqyrton të gjitha kërkesat nga njësitë akademike dhe administrative për nevoja të pajisjeve dhe shërbime të TI-së;
- E koordinon zbatimin dhe mirëmbajtjen e projekteve të TI-së në UHZ;
- Planifikon, dizajnon, integron, bart, freskon, menaxhon dhe mbështet sistemet dhe kërkesat e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë edhe edukimin elektronik;
- E udhëheq dhe e koordinon procesin e freskimit dhe elaborimit të vazhdueshëm të strategjisë së edukimit elektronik, duke propozuar dhe zbatuar aplikacione për mësim në distancë (E-learning);
- Siguron program të aplikueshëm sipas standardeve dhe nevojave për udhëheqjen e lehtë dhe të efektshme të bazave të të dhënave për studentë, për personelin akademik dhe joakademik të UHZ-së;
- Siguron përfshirje të të gjitha njësive të UHZ-së në rrjetin kompjuterik dhe internet;
- Bën zgjerimin e softuerit për regjistrimin e studentëve dhe lidhjen e qendrave në rrjet;
- Organizon perfeksionimin e punëtorëve të cilët punojnë në Zyrën e TI-së në UHZ dhe në njësi akademike (fakultet);
- Kujdeset dhe sugjeron në vazhdimësi stafin akademik dhe administrativ të UHZ-së në lidhje me TI-në;
- I parasheh shpenzimet për teknologji të informacionit në UHZ dhe parasheh planet e buxhetit për projektet e TI-së dhe zbatimin e tyre;
- Kryen edhe punë të tjera të TI-së, të cilat janë të nevojshme dhe të domosdoshme për UHZ-në, si dhe ato të cilat i kërkojnë udhëheqësit e lartë të UHZ-së;

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së dhe Prorektori për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Diplomë universitare në Teknologji Informativ (TI), Shkenca Kompjuterike apo nivele relevante; e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

10.1.1 Administrator i Rrjetit

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Planifikon, udhëheq dhe operon drejtpërdrejt në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, në lëmin e rrjetave kompjuterike si LAN, ËAN, VPN Intranet dhe Internet;
- E administron rrjetin kompjuterik të Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë;
- Bën rekomandime tek administratori i serverëve, përfshirë këtu kufizimet e nevojshme për lidhje në rrjet, si dhe privilegjet e caktuara të shfrytëzuesit të fundit;
- E rregullon rrjedhjen e instalimeve administrative të sistemeve operative për rrjetin e UHZ-së;
- I përdor sistemet më të preferuara operative për sistemin e rrjetave;
- Merret me problemet që shfaqen në harduer (pajisje fizike) dhe softuer (sistemi operativ);
- Bën planin dhe zbatimin që kërkohet në ndryshimin e rrjeteve lokale të ekzistuar më parë;

- Bën koordinimin me provajderat (ISP-të) lokalë për koordinimin e linkut me kualitet më të mirë, si dhe bën përcjelljen e atij linku;
- E përcjell rrjedhjen e bandëidhtit të cekur në kontratë me UHZ-në dhe operatorin ekonomik përgjegjës; e përcjell rrjedhjen e routerave në konfigurim dhe instalim, si dhe i mirëmban.
- Bën kabllimin, konfigurimin dhe instalimin e pajisjeve për lidhjen në rrjet të kompjuterëve dhe sistemeve operative të cilat i posedon Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë;
- Sipas nevojës kryen edhe punë softuerike dhe harduerike (kujdeset për funksionalitetin e pajisjeve operues me të cilat disponon stafi i AQ)
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti FIEK-Drejtimi Kompjuterikë – Telekomunikacion ose FSHMN-Drejtimi i Shkencave Kompjuterike apo fusha relevante, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

10.1.2 Administrator i rrjetit të komunikimeve

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E administron ueb-sajtin e Rektoratit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
- Krijon subdomene për të gjitha njësitë administrative dhe akademike të UHZ-së;
- U jep përkrahje sub(nën)-administratorëve që i administrojnë ueb-faqet e Fakulteteve (njësive akademike) dhe ua ndan të drejtat nga CMS-i;
- Është përgjegjës për hapjen e e-mailave zyrtarë të stafit akademik dhe administrativ të UHZ-së dhe bën administrimin e tyre;
- Plason, ndryshon dhe fshin shënime në ueb-sajtin e UHZ-së;
- Sipas nevojës kryen edhe punë softuerike dhe harduerike (kujdest për funksionalitetin e pajisjeve operues me të cilat disponon stafi i AQ)
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti FIEK- Drejtimi Kompjuterikë – Telekomunikacion ose FSHMN - Drejtimi i Shkencave Kompjuterike apo fusha relevante, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

10.1.3 Administrator i Qendrës së të dhënave

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Krijon baza të të dhënave sipas nevojës;
- Administron të gjitha bazat e të dhënave në UHZ;
- Krijon dhe administron baza të të dhënave relacionare;
- Bënë sigurinë e bazave të të dhënave;
- Në mënyrë të vazhdueshme bënëback – UHZ të bazave të të dhënave;

- Sipas nevojës kryen edhe punë softuerike dhe harduerike (kujdest për funksionalitetin e pajisjeve operues me të cilat disponon stafi i AQ)
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti FIEK- Drejtimi Kompjuterikë –ose FSHMN - Drejtimi i Shkencave Kompjuterike apo fusha relevante, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

10.1.4 Zyrtar për TI

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E administron ueb-faqen e Fakultetit përkatës;
- Vepron në përputhje të plotë me normat ligjore të miratuara nga organet përgjegjëse;
- U jep përkrahje zyrtarëve për softuerin e shërbimeve studentore;
- Jep përkrahje softuerike për Fakultetin;
- Jep përkrahje harduerike për Fakultetin;
- Jep përkrahje për rrjetin dhe internetin e Fakultetit;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1),

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i Zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – FIEK - Drejtimi Kompjuterikë-Telekomunikacion, FSHMN- Drejtimi i Shkencave Kompjuterike apo fusha relevante, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vit përvojë pune të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

11. Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim

11.1 Drejtor i Zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Zyra është mbështetës i KMCV-së në iniciimin dhe koordinimin e iniciativave dhe në zbatimin e vazhdueshëm për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.
- Zyra organizon një monitorim sistematik të treguesve të miratuar të cilësisë, veçanërisht aktiviteteve si në vijim:
- Implementon Planin e Aktiviteteve të sigurimit të cilësisë të aprovuar nga KMCV,
- Mbledhë informacione për cilësi dhe vlerësim nga të gjithë akterët e sistemit brenda Universitetit,
- Në bashkëpunim me KMCV dhe Koordinatorët për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim organizon procesin e vlerësimit të brendshëm sipas Manualit për Sigurim të Cilësisë, përmes pyetësorëve dhe instrumenteve të tjera të parapara në Manual,
- Shpërndan pyetësorët, mbledh, përpunon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e vlerësuara,

- Ofron mbështetje për Komisionet Ad Hoc në procesin e vlerësimit të ndryshimeve dhe plotësimeve në programet ekzistuese të studimit, si dhe në procedura të vlerësimit të brendshëm periodik.
- Ofron mbështetje administrative në procedurat e vlerësimit të brendshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë së Universitetit.
- I ofron mbështetje njësive akademike përmes koordinatorëve për cilësi dhe vlerësim
- Mbledhë, përpunon dhe analizon të dhënat e nevojshme për përpilimin e raportit vjetor të punës
- Koordinon punën në mbështetje të njësive akademike për procesin e Ri/Akreditimit institucional dhe të Ri/Akreditimit të programeve të studimit, bazuar në udhëzuesit dhe standardet e AKA-së,
- Mirëmban dhe i shqyrton dokumentacionin e procesit të ri/akreditimit, përgatitë raporte dhe analiza përkatëse.
- Për përmbushjen e detyrave të përmendura, Zyra bashkëpunon me të gjithë organet përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetit.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së dhe Prorektorit, për Bashëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore master, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

11.1.1 Zyrtar për sigurim të cilësisë

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Ofron mbështetje administrative për procedurat dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë në UHZ;
- Shpërndan pyetësorë për vlerësimet e ndryshme të cilësisë të paraparë sipas rregullores për Sistemin e Sigurimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në UHZ;
- Mbledh përpunon dhe analizon të dhënat e mbledhura nga Koordinatorët për sigurim të cilësisë në Njësi Akademike;
- Bazuar në analizën e pyetësorëve për cilësi, përpilon raporte për shërbimet akademike dhe administrative që i ofron UHZ-ja;
- I mirëmban dhe i shqyrton dosjet e procesit të vlerësimit të njësive akademike;
- I ofron mbështetje njësive akademike përmes Koordinatorëve për cilësi dhe vlerësim
- I ofron mbështetje teknike Komisionit për Menaxhimin dhe Vlerësimit të cilësisë në UHZ;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – fakulteti, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, njohja e gjuhës angleze dhe njohuritë për trendin e arsimit të lartë evropian.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

11.1.2 Zyrtar për procesin e akreditimit

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Ofron mbështetje administrative për procesin e akreditimit institucional dhe të programeve në Universitet;
- I kontrollon aplikacionet e Universitetit sipas akteve ligjore në fuqi, të Agjencisë për Akreditim dhe dokumenteve të tjera përkatëse;
- E përcjell progresin e aplikacioneve të Universitetit që nga përgatitja për aplikim e deri te zbatimi i rekomandimeve;
- I mirëmban dhe i shqyrton dosjet e procesit të akreditimit dhe përgatit raporte dhe analiza përkatëse;
- Ofron mbështetje administrative për proceset e tjera të vlerësimit të jashtëm të Universitetit;
- Ofron mbështetje teknike gjatë takimeve të ndryshme me Agjencinë për Akreditim dhe me palë të tjera të interesit;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – fakulteti, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, njohja e gjuhës angleze dhe njohuritë për trendin e arsimit të lartë evropian.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

12. Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar

12.1 Drejtor i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Përkrah zhvillimin e bashkëpunimit ndëruniversitar ndërkombëtar nëpërmjet marrëveshjeve dhe protokolleve;
- Koordinon dhe i përkrah projektet rajonale dhe ndërkombëtare me interes për UHZ-në;
- Harton dhe zbaton projekte të cilat e avancojnë punën kërkimore dhe shkencore në UHZ, në bashkëpunim me Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë;
- Ndhmon në krijimin e lidhjeve me Universitetet e huaja, i këshillon profesorët në krijimin e këtyre lidhjeve;
- Mbledh të dhëna për fondet kombëtare dhe ndërkombëtare në dispozicion për lëvizje të studentëve dhe të mësimitdhënësve (p.sh. DAAD, EU, Fulbright, British Council, etj), si dhe shpërndan informacione nëpër fakultete;
- Siguron informata nga institucionet relevante ndërkombëtare për arsim dhe inicim të bashkëpunimit;
- E Udhëheqë Programin veror të Universitetit;
- Merr pjesë si anëtar i komisionit me qëllim të planifikimit të Strategjive të mëtutjeshme për zbatimin e suksesshëm të projektit;
- E ndihmon Rektorin dhe Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë në të gjitha nivelet për Bashkëpunim Ndërkombëtar;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi;

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së dhe Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Doktor ose master, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

12.1.1 Zyrtar për Bashkëpunim Ndërkombëtar

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I përgatit propozim-marrëveshjet dhe protokollet për bashkëpunim ndëruniversitar ndërkombëtar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze;
- Bën përgatitjen e korrespondencës ndërkombëtare në gjuhë të huaja për rektorin, prorektorin për marrëdhënie me jashtë dhe për udhëheqësit e tjerë në Universitet;
- Sjell dhe shpërndan informata lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare ndëruniversitare;
- Ndihmon në krijimin e lidhjeve me universitetet e huaja, i këshillon profesorët në krijimin e këtyre lidhjeve;
- Mbledh të dhëna për fondet kombëtare dhe ndërkombëtare në dispozicion për lëvizje të studentëve dhe të mësimitdhënësve, si DAAD, EU, Fulbright, BritishCouncil, si dhe shpërndan informacione nëpër fakultete;
- Bën përkthimin e informatave gojorishit ose me shkrim;
- Sipas udhëzimit të zyrtarit të lartë, përcjell informata e raporte nga institucionet relevante ndërkombëtare për arsim, i kontakton universitetet për të iniciuar bashkëpunimin;
- Nëpërmjet zyrtarit të lartë i përgatit materialet e Zyrës për marrëdhënie me jashtë për publikim në ueb-faqe;
- Mbledh të dhëna për fondet ndërkombëtare për bursa të studentëve dhe të profesorëve.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

I. Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e nevojshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

12.1.2 Zyrtar për projekte ndërkombëtare

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Harton projekte në bazë të nevojave të fakulteteve dhe ndihmon në seleksionimin dhe përgatitjen e projekteve për aplikim në organizata të ndryshme ndërkombëtare;
- U ndihmon fakulteteve në gjetjen e fondeve dhe partnerëve për projektet e tyre;
- Merret në mënyrë eksplicite me organizimin, monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të programeve të Komisionit Evropian: "ErasmusMundusAction 2" (Basileus dhe JoinEU SEE);
- Shërben si person kontaktues në UHZ për projekte "Tempus" dhe për projekte të tjera të ofruara nga institucionet ndërkombëtare për UHZ-në;
- I udhëheq procedurat e aplikimit në programet "JOINEUSEE" dhe "BASILEUS" dhe e bën kontrollimin teknik të aplikacioneve të studentëve dhe të stafit akademik gjatë fazës së aplikimit;
- I promovon grantet evropiane, si dhe ofron ndihmë për aplikim në to, organizon ditë informative për projekte ndërkombëtare që ofrojnë bursa për studentë dhe staf akademik, si dhe panaire të edukimit;

- Asiston në procedurat financiare të programeve "Basileus" dhe "Join EU See", "Erasmus Mundus Action 2";
- Ndihmon në organizimin e Universitetit Veror Ndërkombëtar të Pejës dhe aktivisht merr pjesë në ngjarjet e organizuara;
- I organizon ngjarjet akademike të UHZ-së dhe asiston në çështjet protokollare;
- E pasuron ueb-faqen e UHZ-së me informata për projekte dhe aktivitete ndërkombëtare për arsim të lartë;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e nevojshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

13. Zyra për Zhvillim të Karrierës

13.1 Drejtor i zyrës

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Zhvillim të Karrierës janë:

- Inicion marrëveshje të mundshme mes UHZ-së dhe organizatave – kompanive të ndryshme, me qëllim të krijimit të vendeve për punë praktike apo edhe punësimin të studentëve të UHZ-së;
- Mbanë takime me stafin menaxherial, stafin akademik, stafin administrativ të Universitetit, me punëdhënës, vizitorë të huaj, etj;
- Koordinon hulumtime të ndryshme që realizon QZHK-ja, si dhe harton plane për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të QZHK-së;
- Merr pjesë në konferenca, seminare, trajnime, tryeza të rumbullakëta që ndërlidhen me zhvillimin e karrierës së të rinjve, etj;

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretari i përgjithshëm i UHZ-së dhe Prorektorit për Bashëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

13.1.1 Zyrtar i Qendrës së Karrierës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- I regjistron studentët që i vizitojnë zyrat e QZHK-së, i informon ata për shërbimet që i ofron QZHK-ja, organizon dhe prezanton punëtori me qëllim të këshillimit në karrierë;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për programet e punës praktike, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave të studentëve, të profileve të kompanive, përgatit marrëveshje të mirëkuptimit, forma të aplikimit dhe të regjistrimit për praktikë, e rifreskon databazën e punëdhënësve;
- I hulumton nevojat e tregut të punës dhe të studentëve, përpilon pyetësorë;

- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – fakulteti, e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vite përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

14. Zyra për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore

14.1 Drejtor i Zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Në mënyrë të pavarur kryen punët e caktuara e më pak të specializuara administrativo - teknike duke iu përmbajtur afateve ligjore;
- Punon në rregullimin e dosjeve dhe dokumentacioneve të dosjeve, kujdeset për kompletimin e tyre sipas procedurave ligjore të vlefshme,
- Bashkëpunon me zyrtaret për kryerjen e suksesshme të punëve rreth kontratave duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara;
- Kujdeset për dosjet personale të zyrave administrative të caktuar dhe azhuritetin e tyre
- Përgatitë raportet e punës (javore, mujore dhe vjetore) në bashkëpunim në konsultim me drejtorin e zyrës;
- Kujdeset për mbajtjen e saktë të evidencave, aplikimin e formave dhe për përgatitjen e shkresave të ndryshme zyrtare gjithnjë në bashkëpunim me udhëheqësin e zyrës;
- Kujdeset për afatet e ripërtëritjes së kontratave dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të zyrës;
- Mbanë evidencën amë për zyre administrative në UHZ;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretarit të përgjithshëm

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, Juridik ose Filozofik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

14.1.1 Zyrtar i Burimeve Njerëzore

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Në mënyrë të pavarur kryen punët e caktuara e më pak të specializuara administrativo - teknike duke iu përmbajtur afateve ligjore;
- Punon në rregullimin e dosjeve dhe dokumentacioneve të dosjeve, kujdeset për kompletimin e tyre sipas procedurave ligjore të vlefshme,
- Bashkëpunon me zyrtaret për kryerjen e suksesshme të punëve rreth kontratave duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara;
- Kujdeset për dosjet personale të zyrave administrative të caktuar dhe azhuritetin e tyre

- Përgatitë raportet e punës (javore, mujore dhe vjetore) në bashkëpunim në konsultim me drejtorin e zyrës;
- Kujdeset për mbajtjen e saktë të evidencave, aplikimin e formave dhe për përgatitjen e shkresave të ndryshme zyrtare gjithnjë në bashkëpunim me udhëheqësin e zyrës;
- Kujdeset për afatet e ripërtëritjes së kontratave dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të zyrës;
- Mbanë evidencën amë për zyre administrative në UHZ;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtori i zyrës.

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik, Juridik ose Filozofik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

15. Zyra Ligjore

15.1 Drejtor i Zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

1. Mbështet UHZ në çështjet ligjore, politikat e saj dhe çështjet rregullative
2. Ofron këshilla të nevojshme për menaxhmetin e larte, KD-ne dhe çdo Zyra tjetër në lidhje me ligjet e aplikueshme dhe aktivitetet e UHZ-se.
3. Harton rregullore dhe dokumente tjera zyrtare për çështjet ligjore që lidhen drejtpërsëdrejti me punën e UHZ-se
4. Përgatit draftet për të gjitha çështjet kontestuese dhe procedurave gjyqësore si dhe çështjet të tjera që kërkohen nga menaxhmenti i lart.
5. Ben të gjitha përgatitjet dhe shqyrtimin e dokumenteve për mbledhjet e senatit dhe këshillit drejtues të UHZ-se.
6. Përgatit të gjitha draft vendimet për senatin dhe këshillin drejtues të UHZ-se.
7. Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi.

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretarit të përgjithshëm

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Juridik e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

15.1.1 Zyrtar ligjor

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Harton rregullore, udhëzime dhe rekomandime për organet e Universitetit;
- Jep sqarime për dispozita ligjore, për Statut dhe për akte të tjera normative të zbatueshme në Republikën e Kosovë;

- I përgatit format e vendimeve dhe të kontratave të cilat lidhen me personelin e Universitetit dhe me subjektet e tjera me të cilat UHZ ka raporte kontraktuese;
- Përgatit edhe padi ndaj personave dhe subjekteve të tjera të cilat i shkaktojnë dëme Universitetit;
- E përfaqëson Universitetin në të gjitha procedurat të cilat zhvillohen në gjykatat e Kosovës dhe në organet e administratës, sipas autorizimit të sekretarit të përgjithshëm dhe rektorit;
- Nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm jep përgjigje në kërkesat që i drejtohen Këshillit Drejtues dhe Senatit, si dhe jep sqarime juridike për organet e Universitetit;
- Sipas kërkesës së drejtorit të zyrës përgatit materialet për mbledhjet e organeve të Universitetit dhe merr pjesë në mbledhje, shkruan procesverbalin, vendimet, konkluzionet, rekomandimet si dhe ekstraktin e procesverbalit nga mbledhjet e organeve të Universitetit;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi.

Numri i posteve: Dy (2)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Juridik katër vjeçar ose master në Fakultetin Juridik, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: P

16. Zyra e Protokolit dhe Arkivës

16.1 Drejtor i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Menaxhon organizimin e punës si dhe përcakton detyrat e stafit në Zyrën e Protokolit (Shkrimorës);
- Organizon punën e Zyrës së Protokolit (Shkrimorës), kujdeset për zbatimin e drejt të dispozitave të sistemit të menaxhimit me shkresa;
- Përcjell harmonizimin dhe regjistrimin e lëndëve sipas Departamenteve, shikon mirëmbajtjen e statistikave të Departamenteve të UHZ-së;
- Përcjell sistemimin e dokumenteve në mënyrë elektronike për të gjitha Departamentet e UHZ-së dhe siguron që të gjitha të dhënat janë të gatshme për qasje zyrtare nga personat e autorizuar;
- Siguron që dokumentacioni në arkivin doracak ruhet sipas procedurave, kështu që të jetë në dispozicion në çdo kohë për përdorim ;
- Siguron që dokumentacioni i marrë në shfrytëzim evidentohet;
- Shërben si person kontaktues për njësinë funksionale me kërkesa dhe me çështje tjera që kanë të bëjnë me Zyrën e Protokolit (Shkrimores);
- Përpilon plane për përmirësimin e teknikave të Zyrës së Protokolit (Shkrimores) duke u bazuar në teknologjinë e re.
- Siguron që puna në Zyrën e Protokolit (Shkrimores) të udhëhiqet sipas afateve të punës.
- Udhëheq , mbikëqyrë dhe udhëzon stafin e Zyrës së Protokolit (vartësit direkt) si dhe menaxhon dhe evaluan performancën e tyre;
- Në bashkëpunim me NJBNJ dhe Menaxhmentin e UHZ-së, përkujdeset për zhvillimin dhe ngritjen profesionale të punonjësve të Zyrës së Protokolit;

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretarit të përgjithshëm

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Diplomë universitare Juridik/ Shkenca Shoqërore; e nevojshme njohja e punës me kompjuter dhe njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Katër vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

16.1.1 Zyrtar dërgues

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E arkivon dokumentacionin zyrtar të Universitetit në bazë të nomenklaturës së paraparë me rregullat për mbajtjen dhe për regjistrimin e materialit arkivor, e udhëheq librin arkivor dhe e pranon materialin arkivor nga shërbimet përkatëse;
- E përgatit dhe bën propozim për shkatërrimin e materialit të regjistruar, si dhe mban evidencë për këtë;
- I përcjell dhe i aplikon dispozitat ligjore me të cilat rregullohet mënyra e udhëheqjes së lëndës arkivore;
- Me lejen e rektorit dhe të sekretarit të përgjithshëm jep në përdorim të përkohshëm lëndën arkivore me revers;
- E mban dhe e udhëheq protokollin kryesor për regjistrimin e lëndëve, shpërndan dërgesa postare pasi t'i pranojë nga rektori apo nga sekretari i përhershëm;
- Shpërndan shkresa, vendime dhe materiale të tjera nëpërmjet librit të brendshëm të shpërndarjes për gjithë personelin e Rektoriit; bën fotokopje të materialeve dhe i radhit ato;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Dy vite përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

16.1.2 Zyrtar Regjistruar

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E arkivon dokumentacionin zyrtar të Universitetit në bazë të nomenklaturës së paraparë me rregullat për mbajtjen dhe për regjistrimin e materialit arkivor, e udhëheq librin arkivor dhe e pranon materialin arkivor nga shërbimet përkatëse;
- E përgatit dhe bën propozim për shkatërrimin e materialit të regjistruar, si dhe mban evidencë për këtë;
- I përcjell dhe i aplikon dispozitat ligjore me të cilat rregullohet mënyra e udhëheqjes së lëndës arkivore;
- Me lejen e rektorit dhe të sekretarit të përgjithshëm jep në përdorim të përkohshëm lëndën arkivore me revers;
- E mban dhe e udhëheq protokollin kryesor për regjistrimin e lëndëve, shpërndan dërgesa postare pasi t'i pranojë nga rektori apo nga sekretari i përhershëm;
- Shpërndan shkresa, vendime dhe materiale të tjera nëpërmjet librit të brendshëm të shpërndarjes për gjithë personelin e Rektoriit; bën fotokopje të materialeve dhe i radhit ato;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Dy vite përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

16.1.3 Zyrtar për arkiv

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E arkivon dokumentacionin zyrtar të Universitetit në bazë të nomenklaturës së paraparë me rregullat për mbajtjen dhe për regjistrimin e materialit arkivor, e udhëheq librin arkivor dhe e pranon materialin arkivor nga shërbimet përkatëse;
- E përgatit dhe bën propozim për shkatërrimin e materialit të regjistruar, si dhe mban evidencë për këtë;
- I përcjell dhe i aplikon dispozitat ligjore me të cilat rregullohet mënyra e udhëheqjes së lëndës arkivore;
- Me lejen e rektorit dhe të sekretarit të përgjithshëm jep në përdorim të përkohshëm lëndën arkivore me revers;
- E mban dhe e udhëheq protokollin kryesor për regjistrimin e lëndëve, shpërndan dërgesa postare pasi t'i pranojë nga rektori apo nga sekretari i përhershëm;
- Shpërndan shkresa, vendime dhe materiale të tjera nëpërmjet librit të brendshëm të shpërndarjes për gjithë personelin e Rektoratit; bën fotokopje të materialeve dhe i radhit ato;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Dy vite përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

16.1.4 Zyrtar administrativ i Arkivit në njësi Akademike

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- E arkivon dokumentacionin zyrtar të Universitetit në bazë të nomenklaturës së paraparë me rregullat për mbajtjen dhe për regjistrimin e materialit arkivor, e udhëheq librin arkivor dhe e pranon materialin arkivor nga shërbimet përkatëse;
- E përgatit dhe bën propozim për shkatërrimin e materialit të regjistruar, si dhe mban evidencë për këtë;
- I përcjell dhe i aplikon dispozitat ligjore me të cilat rregullohet mënyra e udhëheqjes së lëndës arkivore;
- Me lejen e rektorit dhe të sekretarit të përgjithshëm jep në përdorim të përkohshëm lëndën arkivore me revers;
- E mban dhe e udhëheq protokollin kryesor për regjistrimin e lëndëve, shpërndan dërgesa postare pasi t'i pranojë nga rektori apo nga sekretari i përhershëm;

- Shpërndan shkresa, vendime dhe materiale të tjera nëpërmjet librit të brendshëm të shpërndarjes për gjithë personelin e Rektoratit; bën fotokopje të materialeve dhe i radhit ato;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

Dy vite përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: A

17. Zyra për Shërbime të përgjithshme të Transportit

17.1 Drejtori i zyrës

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Siguron shfrytëzimin optimal në mënyrë që të plotësohen nevojat operuese të UHZ -së;
- Mbikëqyrë dhe përcakton nevojat për transport;
- Siguron disponueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shërbimit të transportit me mbështetje teknike për të mundësuar që të gjitha komponentët ta kryejnë detyrën e tyre në mënyrë efektive dhe me kohë.
- Mbikëqyrë alokimin e zyrave dhe hapësirës, duke përfshirë ndërlidhjen me palët relevante;
- Mbikëqyrë dhe menaxhon Objektet e Universitetit;
- Ofron furnizim efikas / mbështetje me artikuj të nevojshëm dhe siguron shpërndarjen me kohë;
- Menaxhon pranimin, ruajtjen dhe shitjen e artikujve të zhvlerësuar të pronës së UHZ-së sipas rekomandimit të Menaxhmentit të Lartë;
- Siguron regjistrimin e duhur e të gjithë artikujve të konsumueshëm (shpenzues dhe jo-shpenzues) në pajtim me rregullat dhe rregulloret e AKP-së.
- Mbikëqyr Inventarin dhe Kontrollin e Pronës për të siguruar inspektim të rregullt dhe me kohë të të gjitha asetëve sipas rregullave dhe rregulloreve të UHZ- së;
- Përgatit dhe dorëzon raportet e veçanta dhe të kohëpaskohshme, sipas kërkesës së Menaxhmentit të UHZ-së dhe Auditorit të Jashtëm.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Sekretarit të përgjithshëm

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Diplomë Universitare në Biznes, Menaxhment, Injineri, Administrim Publik, Juridik apo në ndonjë fushë relevante;

IV. Përvoja e përgjithshme:

Tre vjet përvojë pune nga fusha të ngjashme.

V. Kategoria funksionale: D

17.1.1 Koordinator i shërbimeve të përgjithshme dhe zyrës së transportit

I. Detyrat – përgjegjësitë:

- Ofron furnizim efikas / mbështetje me artikuj të nevojshëm dhe siguron shpërndarjen me kohë;
- Menaxhon pranimin, ruajtjen dhe shitjen e artikujve të zhvlerësuar të pronës së UHZ-së sipas rekomandimit të Menaxhmentit të Lartë;
- Mbikëqyr Inventarin dhe Kontrollin e Pronës për të siguruar inspektim të rregullt dhe me kohë të të gjitha asetëve sipas rregullave dhe rregulloreve të UHZ-së;
- Përpilon kërkesa për material zyrtar për tërë personelin e UHZ-së;
- Përpilon kërkesa për riparimin e pajisjeve elektronike në nivel të UHZ-së;
- Rezervon bileta të udhëtimeve zyrtare të personelit vendor dhe të profesorëve vizitorë të UHZ-së;
- Kryen punë të nevojshme logjistike me firma apo kompani kontraktuese;
- Bën llogaritjen e shpenzimeve të derivateve të personave të autorizuar nga UHZ-ja;
- Kujdeset për materialin zyrtar në depon e Rektoratit (zarfe, stilolapsa, mbështjellëse, dosje, tonerë etj.);
- E mban evidencën e zotimeve të cilat i bën zyrtari për zotime;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat ia cakton udhëheqësi i zyrës

Numri i posteve: Një (1)

II. Nëpunësi mbikëqyrës:

Drejtor i zyrës

III. Kualifikimi dhe aftësitë:

Përgatitja shkollore superiore – Fakulteti Ekonomik ose Fakulteti Juridik dhe i certifikuar nga MEF – Departamenti i Thesarit me modulën e pranimit, e nevojshme njohja e punës me kompjuter, e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze.

IV. Përvoja e përgjithshme:

